

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË



Nr. 726 Prot.

Datë 16 /05/2024

Nr. 12921 Prot.

Datë 16 /05/2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
MIDIS
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
DHE
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Shkolla e Magjistraturës (SHM), person juridik, që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i përfaqësuar nga **Drejtori, Z. Arben Rakipi**,

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), organ kushtetues, që ushtron veprimtarinë në bazë Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjet nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korruzionin dhe krimin e organizuar”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, përfaqësuar nga **Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë**,

SHM dhe ILD (këtu e në vijim të quajtura “Palët”), bien dakord për sa vijon:

NENI 1 **QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit midis Shkollës së Magjistraturës dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në fusha me interes të përbashkët.

NENI 2 **OBJEKTIVAT**

Palët angazhohen për të bashkëpunuar ngushtësisht për çështjet me interes të përbashkët, me qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- a) Forcimin e bashkëpunimit për përfshirjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës module dhe tema trajnimi të përshtatshme në interes të inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit çdo vit;
- b) Organizimin e konferencave të përbashkëta, leksioneve të hapura apo aktiviteteve të tjera në funksion të rritjes së eficencës së veprimtarisë dhe zhvillimit profesional të inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve;
- c) Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me analiza apo të dhëna që i shërbejnë aktiviteteve të përbashkëta.

NENI 3 **MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT**

1. Me qëllim përbushjen e objektivave të këtij memorandumi, secila palë do të caktojë një person si bashkëkoordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.
2. Palët angazhohen për gatishmërinë dhe bashkëpunimin e vazdueshëm për çështje me interes të përbashkët.
3. Palët bien dakord se do të organizohen për të vënë në dispozicion të publikut të gjërë, informacionin dhe rezultatet e çdo veprimi të përbashkët, përmes faqeve zyrtare dhe mjeteve të tjera të komunikimit publik.

NENI 4
KOHËZGJATJA E MEMORANDUMIT

1. Ky memorandum bashkëpunimi lidhet për një afat kohor të papërcaktuar.
2. Dispozitat e këtij memorandumi nuk mund të ndryshohen, përmirësohen ose revokohen përveç se me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.
3. Ky memorandum mund të shfuqizohet me kërkesën e njërsës palë, pas njofshitit paraprak me shkrim, e cila parashtron edhe arsyet e prishjes së këtij memorandumi, të paktën 3 muaj përpara.

NENI 5
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI

Ky memorandum nënshkruhet në katër kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

Për Shkollën e Magjistraturës



Arben Rakipi
DRËJTOR

Për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë



Artur Metani
INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË